



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:213943

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05535651

P.nr. 2720/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, me Bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur, sipas detyrës zyrtare, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.K, për shkak te veprës penale “Hyrja ne sistemet kompjuterike” nga neni 327 par. 1 te KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 4635/2022 të datës: 14.10.2022, jashtë seance, në mbështetje të nenit 357 par.1 nen par 1.3 të KPPR-ës, me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 4635/2022 të datës: 14.10.2022, si dhe,
- II. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit A.K nga babai M dhe nena H, e gjinisë H, i lindur me “data e lindjes” ne Prizren, me vendbanim ne “vendlindja” te Gjermanisë, me nr. personal “letërnjoftim”, i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës
- III. Për shkak se nuk është plotësuar aktakuza PP/II.nr. 4635/2022 të datës: 14.10.2022.
- IV. Pala e dëmtuar RTK-live.com, me seli në Prishtinë, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.
- V. Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 4635/2022 të datës: 14.10.2022, ndaj të pandehurit A.K për shkak te veprës penale “Hyrja ne sistemet kompjuterike” nga neni 327 par. 1 te KPRK-se.

Lidhur me këtë çështje, gjykata ka bere shqyrtimin e aktakuzës, PP/II.nr. 4635/2022 të datës: 14.10.2022, ndaj të pandehurit A.K për shkak te veprës penale “Hyrja ne sistemet kompjuterike” nga neni 327 par. 1 te KPRK-se. Pas shqyrtimit të saj me vëmendje, ka konstatuar se, aktakuza ka të meta procedurale, sa i përket te dhënave personale te pandehurit A.K pasi që ne këtë aktakuzë është vetëm qyteti ku jeton ne Gjermani mirëpo nuk ka adrese me te sakte qe gjykata te këtë mundësinë qe te njëjtin ta ftoj, po ashtu për gjykatën ishte me rëndësi te kuptonte se a kishte dëm ndaj te dëmtuarit te lartë cekur si dhe nëse kishte dëm sa ishte vlere e atij dëmi ne mënyrë qe te plotësohen elementet e veprës penale e cila i vihet barre te pandehurit.

Gjykata pas shqyrtimit të aktakuzës, duke u bazuar në nenin 235 par 4, të KPPRK-së dhe konstatimeve te të metave të saj, përmes parashtresës së datës: 25.01.2024, ka kërkuar nga prokuroria qe të bëhet plotësimi i aktakuzës, sa i përket çështjeve se cila është adresa e sakte te akuzuarit si dhe vlere e demit si element qe duhet përmbushur për veprën penale ndaj të akuzuarit A.K po ashtu ka kërkuar nga ana e Prokurorisë së Shtetit qe në afat prej 15 ditësh të bëhet plotësimi i aktakuzës PP/II.nr. 4635/2022 të datës: 14.10.2022.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, edhe pse ka pranuar në mënyrë të rregullt me datë: 29.01.2024, kërkesën për plotësim të datës: 25.01.2024, e njëjta nuk ka plotësuar aktakuzën e lartcekur.

Andaj gjykata nga të lartcekurat, duke u bazuar në nenin 235 par 4, të KPPRK-së, si ka kërkuar plotësimin i e aktakuzës, duke kërkuar qe brenda 15 ditëve Prokurori te beje plotësimin e saj, mirëpo Prokuroria Themelore ne Prishtine, nuk ka bërë plotësimin e aktakuzës PP/II.nr. 4635/2022 të datës: 14.10.2022, sipas kërkesë së gjykatës, andaj gjykata ne harmoni te nenit 235 par. 4 si dhe të nenit 357 par. 1 nen par. 1.3 te KPPRK-ës, ka vendosur qe të hedh aktakuzën ndaj të pandehurit A.K për shkak të mosplotësimit të aktakuzës, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që nuk mundë të vazhdohet tutje me procedurën penale.

Gjykata lidhur me këtë çështje e ka hedhë poshtë aktakuzën të pa plotësuar dhe të pa korrigjuar, konform nenit 235 par.4 lidhur me nenin, 357 par 1 nen par 1.3 te KPPRK-ës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimin lidhur me udhëzimin ne palës së dëmtuar në kontest juridiko civil është mbështetur në nenin 462 par 3 të KPPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedure penale e ka bazuar në neni 453 par 1 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I  
PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL  
2022:213943, 03.04.2024**

Bashkëpunëtori Profesional  
Asdren Selmani

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Sabit Sadikaj

**KËSHILLË JURIDIKË:** Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 3 (tri) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.